



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/26
Datë: 23.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 119 paragrafit 9 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 paragrafit 1 lidhur me nenin 43 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ndryshuar me ligjet nr. 04/L-111 dhe 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 paragrafin 2.4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 prill 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Shkarkohet nga Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Qendrore "Telekomi i Kosovës" Sh.A. drejtorët si në vijim:
 - 1.1. Luljeta Elezaj;
 - 1.2. Teki Shala.
2. Emërohet në Bordin e Përkohshëm të Drejtorëve të ndërmarrjes nga pika 1:
 - 2.1. Lule Ahmedi, drejtoreshë;
 - 2.2. Hekuran Nikçi, drejtor.
3. Drejtorët e emëruar sipas pikës 2 shërbejnë për të njëjtin mandat si drejtorët e emëruar me Vendimin e Qeverisë nr. 08/05 të 6 marsit 2020.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Për arsyet e cekura në memorandumimin shpjegues të Ministres së Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrjes dhe Investimeve Strategjike, Qeveria vendosi si në dispozitiv.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë
- Ndërmarrjes "Telekomi i Kosovës" Sh.A.



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike
Ministarstvo Ekonomije, Zapošljavanja, Trgovine, Industrije, Preduzetništva i Strateških Investicija
Ministry of Economy, Employment, Trade, Industry, Entrepreneurship and Strategic Investments

DATË/E:	22.4.2020
PËR/ZA/TO:	Qeverinë e Republikës së Kosovës
NGA/OD/FROM:	Rozeta HAJDARI – Ministre në detyrë, MEPTINIS
TEMA/ SUBJEKAT/ SUBJECT:	Memorandum shpjegues për propozim-vendimin për shkakimin dhe zëvendësimin e drejtorëve në bordin e përkohshëm të ndërmarrjes “Telekomi i Kosovës” ShA

I nderuar z. Kryeministër Kurti,
i nderuar z. Zëvendëskryeministër Abazi,
të nderuar kolegë ministra:

Ndërmarrja “Telekomi i Kosovës” ShA po vijon të përballet me vështirësi të rënda, që përfshijnë thellimin e dukshëm të humbjeve dhe problemet me likuiditet. Dy drejtorë në bordin e përkohshëm nuk kanë qenë të gatshëm për të adresuar menjëherë përgjegjësinë për gjendjen. Si Qeveri, kemi arsye të besojmë se këta drejtorë mund të kenë shkelur detyrat fiduciare me mosgatishmërinë e tyre, andaj propozoj që Qeveria t’i shkarkojë dhe t’i zëvendësojë ata sipas ligjit.

1. Shkarkimi i drejtorëve

Neni 119.9 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës thotë:

Republika e Kosovës ushtron të drejtën e pronësisë mbi çdo ndërmarrje që ajo kontrollon në pajtim me interesin publik, me qëllim që të maksimizojë vlerën afatgjate të ndërmarrjes.

Tutje, Ligji për ndërmarrjet publike (LNP) përcakton se si ushtrohet e drejta e pronësisë.¹ Neni 5.1 saktëson:

Qeveria ka kompetencën ekskluzive për ushtrimin e të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës në NP-të Qendrore. Qeveria do të vendos mbi këto çështje me shumicë të thjeshtë votash.

¹ Ligj 03/L-087 për ndërmarrjet publike (LNP), GZRK 31/08, 15.6.2008, ndryshuar me Ligjin 04/L-111, GZRK 13/12, 30.5.2012 (fuqi 15.6.2012), Ligjin 05/L-009, GZRK 10/15, 7.5.2015, dhe Ligjin 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike, GZRK 3/18, 19.4.2018 (fuqi 4.5.2018).

Ministria përgjegjëse për zhvillimin ekonomik ndihmon Qeverinë në ushtrimin e të drejtave të aksionarit.²

Neni 19.3 LNP përcakton detyrimin e Qeverisë për të shkarkuar drejtorin për të cilin besohet se ka shkelur detyrat:

Nëse Aksionari(ët) kanë arsye për të besuar se ka mundësi që një drejtor të ketë bërë shkeljen e detyrave fiduciare, ata menjëherë do ta shkarkojnë dhe zëvendësojnë drejtorin ose drejtorët të cilët me arsye besohet se kanë bërë shkeljen e detyrave të tyre fiduciare, edhe në mungesë të provave të qarta, pavarësisht nga rreziku që mund të paraqesë për NP-në ngritja e një padie nga ana e drejtorit/ëve të shkarkuar.

Detyrat fiduciare përfshijnë detyrimin për të vepruar në interesin më të mirë të ndërmarrjes dhe aksionarit, ashtu siç parashihet dhe me Kodin e etikës dhe të qeverisjes korporative të ndërmarrjeve publike.³

Më 19 shkurt 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës shkarkoi bordin e drejtorëve të Telekomit, ndër të tjera arsye, për shkelje të detyrave fiduciare.⁴ Kurse më 6 mars, emëroi një bord të përkohshëm të drejtorëve, siç kërkon neni 43 LNP.⁵

Deri tani, bordi i përkohshëm ka mbajtur disa mbledhje dhe ka marrë disa vendime të rëndësishme, por nuk ka adresuar çështje kyçe, që lidhen me përgjegjësinë për humbjet e thelluara dhe likuiditetin e cenuar të ndërmarrjes. Gjatë vitit 2019, humbjet e Telekomit janë shtuar mbi 50 për qind, dhe detyrimet janë rritur për 16,3 milionë euro. Në 5-6 muajt e fundit, ndërmarrja nuk ka paguar me rregull as rrogat e punëtorëve. Gjendja ka qenë e rëndë, ndërsa pandemia e ka rënduar më fort.

Por dy nga katër drejtorët joekzekutivë në bord nuk kanë qenë gati të adresojnë përgjegjësinë për këtë gjendje. Në mbledhjen e 21 prillit 2020, kryesuesi i bordit ka propozuar si pikë të rendit të ditës “Diskutim rreth Zyrtarëve të lartë të TK-së të cilët kanë ndikim direkt në performancën e TK”.⁶ Dy drejtorët, z. Teki Shala dhe znj. Luljeta Elezaj, kanë kundërshtuar këtë pikë, me pretendimin se duhet pritur edhe ca.

Z. Shala ka thënë se “duhet të diskutohet në rrethana pak më tjera, menjëherë pasi të fillojë jeta dhe puna pas pandemisë”, dhe ka propozuar që diskutimi “të shtyhet deri sa Qeveria të merr[sic] masa të ardhshme lehtësuese për lëvizje”.⁷ Kurse znj. Elezaj ka arsyetuar shtyrjen “deri sa të krijohen kushtet për diskutim”. Ajo ka kërkuar “që

2 LNP, nenet 5.1 dhe 37.1.

3 Kodi i etikës dhe qeverisjes korporative për ndërmarrjet publike, ribot. 2014, pika 16.4(b). Termi *detyrë fiduciare*, i huazuar nga anglishtja, përkufizohet si detyrë për të vepruar me ndershmërinë e besnikërinë më të lartë ndaj ndërmarrjes dhe në interesin më të mirë të saj. Shih zërin *fiduciary duty* në fjalorin juridik *Black's Law Dictionary*, 9th ed., f. 581.

4 Vendim i Qeverisë 02/03, 19.2.2020.

5 Vendim i Qeverisë 08/05, 6.3.2020.

6 Draft-procesverbali i mbledhjes 67, Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i NP “Telekomi i Kosovës” ShA, 21.4.2020, pika 1.

7 Po aty, pika 1.3.

të presim një raport të auditimit [dhe] që të shtyhet kjo pikë deri sa të qetësohet gjendja”,⁸ ani pse raportet financiare janë të mjaftueshme për të vlerësuar gjendjen dhe për të marrë veprime. Mendimit të tyre u është bashkëngjitur kryeshefi, si drejtor i pesë dhe i vetmi ekzekutiv në bord.⁹ Asnjëri nuk ka paraqitur alternativë për të shpëtuar ndërmarrjen.

Me këtë qasje, dy drejtorët Shala e Elezaj po tregojnë se nuk janë gati për të adresuar përgjegjësinë për gjendjen. Kjo mosgatishmëri i jep aksionarit arsye për të besuar se dy drejtorët nuk po veprojnë në interesin më të mirë të ndërmarrjes, pra po shkelin detyrat fiduciare.

Vlen të përmendet se qëndrimi i dy drejtorëve nuk ka të bëjë me meritat e çështjes — se a duhet vendosur kështu apo ashtu — por me vullnetin për të shqyrtuar çështjen. Kurse çështja është e tillë që prek vetë ekzistencën e ndërmarrjes: thellimin e humbjeve, rritjet e detyrimeve, likuiditetin e cenuar. Telekomu është buzë greminës, dhe nuk ka kohë me pritë.

Fryma e Ligjit për ndërmarrjet publike ngërthen detyrimin për të vepruar *menjëherë, pa vonesë* dhe *sa më shpejt* në mënjanimin e shkeljeve dhe mangësive në qeverisje.¹⁰

2. Zëvendësimi dhe mandati i zëvendësuesve

Me shkarkimin e dy drejtorëve, Qeveria duhet t’i zëvendësojë ata me dy drejtorë të tjerë, për të mundësuar veprimin e bordit të përkohshëm të drejtorëve.¹¹ Por duhet pasur parasysh mandatin e kufizuar të bordit të përkohshëm. Neni 43 thotë mes të tjerash:

43.4 Mandati i secilit Bord të Përkohshëm të Drejtorëve do të skadojë, cilado që ndodh më herët (i) mesnatën e ditës e cila rastis gjashtë (6) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji ose (ii) ditën në të cilën zgjidhet bordi i plotë i drejtorëve për NP-në përkatëse në përputhje me nenin 15 ose 16 të këtij ligji.

43.5 Çdo përpjekje për zgjatjen ose përtëritjen e mandatit të një Bordi të Përkohshëm të Drejtorëve përtej afatit të përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni është e ndaluar, e pavlefshme dhe e pa zbatueshme. Pas skadimit të mandatit të Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve të Përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni, ky bord dhe drejtorët e tij pushojnë të kenë çfarëdo autorizimi të çfarëdo përshtetimi për të vepruar në cilësinë e Bordit të Drejtorëve të NP-së.

Rrjedhimisht, mandati i bordit të përkohshëm ka nisur më 7 mars 2020, të nesërmen e vendimit për emërimin e tij. Dhe meqë Qeveria kurrësi nuk mund t’ia zgjasë man-

8 Po aty, pika 1.4.

9 Po aty, pika 1.5.

10 Shih LNP, nenet 19.3 dhe 23.2 (“menjëherë”), 19.1 dhe 23.1 (“pa vonesë”), 43.2 (“sa më shpejt”).

11 LNP, neni 43.1 lidhur me nenin 19.2.

datin këtij bordi, drejtorët e përkohshëm që emërohen tani mund të shërbejnë vetëm për pjesën e mbetur të mandatit të drejtorëve të tjerë. Saktësisht, bordi i përkohshëm i Telekomit do të shërbejë deri kur të zgjidhet bordi me mandat të plotë, por më së largu deri më 7 shtator 2020.

Dy drejtorët që po propozohen sot – prof. dr. Lule Ahmedi dhe z. Hekuran Nikçi – janë inxhinierë dhe auditor me përvojë të lakmueshme profesionale e akademike, brenda dhe jashtë vendit.

Për arsyet e sipërcekura, ftoj Qeverinë të miratojë vendimin e propozuar.

Rozeta HAJDARI

Ministre në detyrë

Bashkëngjitje: Draft-procesverbali i mbledhjes 67, Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i NP “Telekomi i Kosovës” ShA, 21.4.2020